



MINISTÈRE  
DE LA SANTÉ  
ET DE LA PRÉVENTION

*Liberté  
Égalité  
Fraternité*

# Ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë (IVG)

Skedar udhëzues



# PËRMBLEDHJE

HYRJE.....	3
FAZA E PARË: VIZITA PËR INFORMIM.....	6
FAZA E DYTË: MARRJA E PËLQIMIT .....	8
FAZA E TRETË: REALIZIMI I IVG-së.....	10
IVG-ja kirurgjikale.....	11
IVG-ja medikale .....	12
FAZA E KATËRT: VIZITA E KONTROLLIT.....	15
KONTRACEPSIONI PAS IVG-së.....	17
Rekomandimi i kontracepsionit.....	17
Zgjedhja e kontracepsionit.....	18
Zbatimi i kontracepsionit .....	18
Ku mund të gjeni informacione shtesë mbi kontracepsionin?.....	19
SHTOJCAT .....	21

**E drejta për abort është arritje e madhe për gratë dhe fryt i një lufte të gjatë për të kontrolluar trupin e tyre.** Në shtojcën 5 të këtij dokumenti jepen etapat e ndryshme që rezultuan në garantimin e kësaj të drejte me ligj.

**Pavarësisht nëse është e rritur ose e mitur, çdo grua shtatzënë që nuk dëshiron të vazhdojë shtatzëninë mund t'i kërkojë një mjeku ose një mamie ta ndërpresë atë.** Një kërkesë të tillë mund ta bëjë vetëm gruaja e interesuar. Ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë (IVG) mund të kryhet përpara fundit të javës së 14-të të shtatzënisë, e cila përkon me fundin e javës së 16-të pas fillimit të menstruacioneve të fundit (16 javë amenorre).

---

**!** Në mënyrë që të respektohen afatet, është e rëndësishme që, kur të merret vendimi për të kryer IVG-në, të fillohet shpejt procesi.

---

Ekzistojnë dy teknika të mundshme për kryerjen e IVG-së:

- **metoda kirurgjikale:** mund të kryhet vetëm nga një mjek ose një mami e trajnuar, në një qendër ose institucion shëndetësor;
- **metoda medikale:** mund të kryhet nga mjeku ose mamia.

Duhet theksuar se të gjitha shpenzimet që lidhen me IVG-në rimbursohen në masën 100% nga sigurimet shëndetësore (shtojca 2).


Siç parashikohet nga rregulloret në fuqi, ky udhëzues ka për qëllim t'ju ndihmojë në zgjedhjen tuaj dhe t'ju ofrojë informacionin e nevojshëm për kryerjen e IVG-së.

## Mund të informoheni edhe:

- në numrin kombëtar anonim dhe falas « Sexualités – Contraception – IVG »: **0800 08 11 11**.
- në faqen zyrtare kombëtare: <https://ivg.gouv.fr/>
- në qendrat e shëndetit seksual (ish-CPEF, ish-qendrat për planifikimin ose edukimin familjar) ose në institucionet e informimit, konsultimit dhe këshillimit familjar të quajtura rishtazi «Hapësira të Jetës Emocionale, Relacionale dhe Seksuale» (frëngjisht: EVARS). Adresat dhe të dhënat e kontaktit të këtyre strukturave, të krijuara nga departamenti, mund t'i gjeni në: <https://ivg.gouv.fr/>
- në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Parandalimit: <https://solidarites-sante.gouv.fr/>

## DUA TË NDËRPRES SHTATZËNINË

Caktoj menjëherë  
takim me mjekun  
ose maminë



Nëse dëshironi ta ndërprisni shtatzëninë, mund të caktoni një takim me një mjek ose një mami:

- në një kabinet privat;
- në një qendër të shëndetit seksual (ish-CPEF);
- në një qendër shëndetësore;
- në një institucion shëndetësor (spital ose klinikë).

Ju mund të kërkonte një takim këshillues ku do të merrni pjesë fizikisht ose një telekonsultë (vizitë nëpërmjet internetit ose nga larg) (nëse jua ofron mjeku/mamia) (shih shtojcën 3).



---

**Kushtojuni vëmendje afateve për IVG-në** , sidomos nëse është planifikuar në një institucion shëndetësor.

Jo të gjitha institucionet shëndetësore publike ose private i praktikojnë të dyja teknikat e abortit (kirurgjikal dhe medikal). Është e rëndësishme të informoheni sa më shpejt të jetë e mundur nga institucioni i zgjedhur ose nga numri kombëtar anonim dhe falas « Sexualitës – Contraception – IVG »: **0800 08 11 11**.

Disa institucione janë të mbingarkuara dhe vonesat mund të jenë shumë të gjata. Është e nevojshme të merret parasysh kjo kur të caktoni një takim.

---



# FAZA E PARË: VIZITA PËR INFORMIM



## FAZA E PARË: VIZITA PËR INFORMIM



- Mjeku ose mamia më informon dhe më jep **dokumentacionin**. Nuk hezitohet t'i bëj pyetje
- Ai/ajo më propozon një **konsultim psiko-social**

### KONSULTIMI PSIKO-SOCIAL

- >I detyrueshëm për të miturat
- >Rekomandohet për të rriturat
- >Për të ditur se ku të shkoj dhe të informohem për të drejtat e mia:

**0 800 08 11 11** Shërbimi dhe telefonata anonime dhe falas



### Gjatë kësaj vizite:

- Ju bëni kërkesën për IVG (abort).
- Ju merrni këtë skedar udhëzues dhe informacione verbale:
  - për metodat e ndryshme të IVG-së: kirurgjikale dhe medikale (shih «Kryerjen e IVG-së», faqja 10);
  - për vendet e kryerjes dhe në veçanti për mundësinë e zgjedhjes që ju bëni:
    - për IVG-në kirurgjikale: në një institucion shëndetësor (spital, klinikë) ose në një qendër shëndetësore të autorizuar,
    - për IVG-në medikale: në një institucion shëndetësor (spital, klinikë), në një kabinet privat, në një qendër shëndetësore seksuale (ish-CPEF) ose në një qendër shëndetësore;
  - për rreziqet dhe efektet anësore të mundshme.

- Mjeku ose mamia ju ofron një **intervistë psikosociale. Është fakultative nëse jeni e rritur, por e detyrueshme nëse jeni e mitur.**

Do të keni një seancë dëgjimi (bindjeje), mbështetje psikologjike, informacion ose këshilla të përshtatshme për situatën tuaj. Ky moment dëgjimi (bindjeje) dhe dialogu është i rëndësishëm për t'ju shoqëruar gjatë kësaj periudhe nganjëherë të vështirë.

Për këtë vizitë të parë të informimit, mund të kërkonti një vizitë ku do të paraqiteni fizikisht ose një vizitë nga interneti nëse profesionisti juaj i kujdesit shëndetësor jua ofron këtë të fundit (shih shtojcën 3).

### **Konsultimet psikosociale para IVG-së**

Ajo zhvillohet midis dy fazave para IVG-së. Konsultimi (ose vizita) është **fakultativ nëse jeni e rritur dhe i detyrueshëm nëse jeni e mitur.**

Ai zhvillohet në një Hapësirë të Jetës Emocionale, Relacionale dhe Seksuale (EVARS) (e njohur më parë si institucion informimi, konsultimi ose këshillimi familjar (EICCF)), në një qendër të shëndetit seksual (e njohur më parë si qendra për planifikimin ose edukimin familjar), në një shërbim social ose në një organ tjetër të licencuar, me një profesionist të kualifikuar për këshillimin për martesën dhe familjen.

Gjatë këtij konsultimi do t'ju ofrohet mbështetje sociale dhe psikologjike.

Ju mund të kërkonti një takim për konsultim psikosocial ku do të jeni e pranishme fizikisht ose nga interneti (nëse ju ofrohet) për këtë konsultim (shih shtojcën 3).

Kur profesionisti (mjeku ose mamia) nuk e kryen vetë abortin (IVG), ai/ ajo duhet t'ju japë emrin e një mjeku ose të një strukture që e kryen këtë veprim. Ai jua kthen kërkesën dhe ju jep një dëshmi që vërteton se keni respektuar këtë hap të parë të detyrueshëm (faza e informimit).

## FAZA E DYTË: MARRJA E PËLQIMIT



### FAZA E DYTË: MARRJA E PËLQIMIT



- Unë vendos me mjekun ose maminë time për **mënyrën e ndërhyrjes**, në përputhje me situatën time personale dhe me disponueshmërinë e qendrave mjekësore
- Unë konfirmoj kërkesën time për IVG dhe paraqes **pëlqimin tim me shkrim**
- Nëse nuk e kryen vetë abortin, ai/ajo më jep një **listë specialistësh**
- Në këtë rast, ai/ajo më jep një vërtetim me të cilin konfirmohet se kam respektuar hapat e detyrueshëm paraprakë.

**Nuk ka më afat minimal për të menduar midis fazës së parë dhe fazës së dytë. Mendohuni për aq kohë sa e gjykoni të nevojshme për të marrë vendimin tuaj, duke marrë parasysh afatin ligjor për kryerjen e abortit (IVG-së) (14 javë shtatzëni).**

Nëse keni zgjedhur të bëni intervistën psikosociale (ose nëse është e detyrueshme për shkak të moshës suaj të mitur), kjo do të ndodhë midis këtyre dy fazave të para të procesit të IVG-së.

#### **Për sa i takon fazës së dytë:**

- Ju konfirmoni kërkesën tuaj me shkrim për të bërë IVG-në dhe i jepni pëlqimin tuaj mjekut ose mamisë. Mund të kërkonit një takim konsultimi ku do të merrni pjesë fizikisht ose nga interneti për këtë kohë të marrjes së pëlqimit (shih detajet praktike në shtojcën 3).



- Zgjidhni metodën tuaj të IVG-së, si dhe vendin e kryerjes së saj.
- Bëhet fjalë edhe për një moment të privilegjuar me mjekun ose maminë:
  - për të përcaktuar metodën kontraceptive që duhet zbatuar pas IVG-së;
  - për t'ju rekomanduar, nëse zgjidhni ju vetë, depistimin për infeksione seksualisht të transmetueshme, përfshirë infektimin me HIV, si dhe depistimin për kancerin e qafës së mitrës (nga mosha 25 vjeçare).
- Kur profesionisti (mjeku ose mamia) nuk e kryen vetë IVG-në, ai duhet t'ju japë emrin e një mjeku ose të një strukture që e kryen këtë vepër. Ai jua kthen kërkesën tuaj dhe ju jep një vërtetim që konfirmon se keni respektuar hapat e detyrueshëm paraprakë (kohën e informimit dhe kohën e dhënies së pëlqimit).

### Konsultimet e tjera mjekësore

Kur teknika e parashikuar kërkon anestezi të ndryshme nga anestezia lokale, vizita para-anestetike është e detyrueshme përpara ndërhyrjes kirurgjikale.

## FAZA E TRETË: KRYERJA E IVG-së



### FAZA E TRETË: ABORTI (IVG-JA)

Deri në fund të javës



së 14-të të shtatzënisë



#### METODA KIRURGJIKALE

- Nëse rekomandohet ose zgjidhet anestezia e përgjithshme, unë caktoj një takim për një vizitë para-anestetike.
- Procedura zgjat rreth dhjetë minuta.
- Anestezia lokale ose e përgjithshme: shtrohem në spital për vetëm disa orë.

>Kjo metodë mund të realizohet në një institucion ose në një qendër shëndetësore

Deri në fund të javës



së 7-të të shtatzënisë



#### METODA MEDIKALE

- Gjatë vizitës së parë ose pas saj në shtëpinë time, marr medikamentin e parë (**mifepriston**) që ndërpret shtatzëninë.
- Brenda 36 deri në 48 orësh: marr medikamentin e dytë (**misoprostol**) edhe nëse kam pasur gjakderdhje nga doza e parë. Ky medikament do të shkaktojë abortin.
- Gjakderdhja mund të vazhdojë deri në 10 ditë pas abortit.

> Kjo metodë mund të kryhet në prani të profesionistit të kujdesit shëndetësor ose në shtëpi



Ekzistojnë dy metoda të IVG-së:

- metoda kirurgjikale;
- metoda medikale.

Teknika e përdorur varet nga zgjedhja juaj, pritshmëritë tuaja, kundërintikacionet mjekësore që lidhen me shëndetin ose kushtet tuaja të jetesës dhe nga faza e shtatzënisë. Mund të vendosni me ndihmën e mjekut ose mamiës.

## IVG-ja kirurgjikale

**IVG-ja kirurgjikale mund të kryhet deri në fund të javës së 14-të të shtatzënisë, ose 16 javë pas fillimit të menstruacioneve të fundit.**

Ajo kryhet nga një mjek në një **institucion shëndetësor ose qendër shëndetësore të autorizuar** ose nga një mami e trajnuar, e cila ushtron profesionin në një institucion shëndetësor për ata që kryejnë këtë praktikë.<sup>1</sup>

## Procedura e IVG-së kirurgjikale

### → Metoda

IVG-ja kirurgjikale konsiston në aspirimin e përmbajtjes së mitrës pas zgjerimit të qafës së mitrës. Hapja e qafës së mitrës mund të lehtësohet me dhënien e një medikamenti. Një kanjulë me kalibër të përshtatur për fazën e shtatzënisë futet në mitër nga mjeku ose mami për të aspiruar përmbajtjen e mitrës.

### → Anestezia

Ndërhyrja mund të kryhet me anestezi lokale ose të përgjithshme. Me ndihmën e mjekut ose mamiës, ju zgjidhni mënyrën e anestezisë më të përshtatshme për situatën tuaj.

### → Realizimi

Shpesh, monitorimi për disa orë në institucionin ose qendrën shëndetësore mjafton për kryerjen e abortit, edhe nëse kryhet me anestezi të përgjithshme.

Ndërhyrja zgjat rreth dhjetë minuta.

Do t'ju ofrohet një kontracepsion sapo të realizohet IVG-ja për efekt të menjëhershëm.

<sup>1</sup> Në pritje të dekretit për zbatimin e ligjit, të datës 2 mars 2022, i cili përgjithëson praktikën e IVG-së kirurgjikale nga një mami e trajnuar, e cila e ushtron profesionin në një institucion shëndetësor, ky aktivitet kryhet në kuadër eksperimental në disa institucione.

## Çfarë problemesh mund të shfaqen gjatë IVG-së kirurgjikale?

Komplikacionet e menjëhershme janë të rralla:

- hemorragjia gjatë një IVG-je ndodh shumë rrallë;
- perforimi (shpimi) i mitrës gjatë aspirimit kirurgjikal ndodh jashtëzakonisht rrallë.

Komplikacionet pas IVG-së janë të rralla. Megjithatë, në ditët pas ndërhyrjes, në disa raste mund të keni:

- ethe dhe temperaturë mbi 38°C;
- humbje të konsiderueshme gjaku;
- dhimbje të forta barku;
- gjendje të fikëti (parehati).

**Nëse keni një ose më shumë nga këto simptoma/shenja, duhet të kontaktoni menjëherë me institucionin ku është realizuar aborti ose, në rast të kundërt, me departamentin e urgjencës më të afërt, pasi kjo mund të jetë shenjë komplikacioni.**

## Efektiviteti i metodës

Shkalla e suksesit të metodës kirurgjikale është 99,7%, kështu që rreziku i mossuksesit është shumë i ulët.

## IVG-ja medikale

IVG-ja medikale mund të kryhet deri në fund të javës së **7-të të shtatzënisë**, pra jo më vonë se 9 javë pas fillimit të menstruacioneve të fundit.

IVG-ja medikale kryhet:

- në një institucion shëndetësor (spital, klinikë);
- në një kabinet privat, me një mjek ose mami të licencuar;
- në një qendër të licencuar të shëndetit seksual (që më përpara njihej si qendër për planifikimin ose edukimin familjar);
- në një qendër shëndetësore të licencuar.

Në kabinet, vetëm mjekët ose mamitë që kanë lidhur marrëveshje me një institucion shëndetësor janë të autorizuar të kryejnë IVG-në medikale.

IVG-ja medikale mund të realizohet tërësisht ose pjesërisht, me konsultime nga largësia (shtojca 3).

## Procedura e IVG-së medikale

IVG-ja medikale konsiston në marrjen e dy medikamenteve:

### 1. Marrja e mifepristonit

Ky medikament **mundëson fillimin e ndërprerjes së shtatzënisë**. Medikamenti merret ose në shtëpi ose gjatë një vizite mjekësore.

Bllokon veprimin e hormonit të nevojshëm për mbajtjen e barrës (progesteroni), nxit kontraktimet e mitrës dhe hapjen e qafës së mitrës.

Që nga kjo fazë e parë, mund të shfaqen gjakderdhje dhe dhimbje pak a shumë të forta, por në shumicën e rasteve simptomat fillojnë pas marrjes së medikamentit të 2-të.

---

**Gjakderdhja nuk është shenjë treguese se shtatzënia ka ndaluar. Prandaj është e domosdoshme të merrni medikamentin e 2-të.**

---

Metoda kontraceptive e zgjedhur mund t'ju rekomandohet gjatë kësaj vizite.

### 2. Marrja e misoprostolit, nga 24 deri në 48 orë më vonë

Ky medikament merret ose në shtëpi, ose gjatë një vizite mjekësore ose gjatë një qëndrimi të shkurtër në spital. Ai rrit kontraktimet dhe shkakton IVG-në (abortin). Kontraktimet e mitrës shkaktojnë dhimbje të ngjashme me atë të menstruacioneve, ndonjëherë më të forta (dhimbje legeni), të cilat mund të zbuten me dhënien me recetë nga mjeku të analgjezikëve.

Gjakderdhja shpesh mjaft e madhe që shoqëron evakuimin e barrës mund të ndodhë shumë shpejt pas marrjes së misoprostolit, por ndonjëherë më vonë:

- në 60% të rasteve, evakuimi i barrës ndodh brenda 4 orëve nga marrja e misoprostolit;
- në 40% të rasteve, evakuimi i barrës ndodh brenda 24 deri në 72 orëve nga marrja e misoprostolit.

Gjakderdhja zakonisht zgjat pesëmbëdhjetë ditë.  
Kjo metodë nuk kërkon anestezi ose kirurgji nëse është e suksesshme.

### Çfarë problemesh mund të shfaqen gjatë IVG-së medikale?

Efektet anësore më të shpeshta të menjëhershme joshqetësuese janë:

- dhimbje pelvike për të cilën mjeku ose mamia ju rekomandon analgjezikë;
- gjakderdhje;
- çrregullime të tretjes: të përziera, të vjella, diarre.

**Në ditët pas IVG-së, nëse shfaqni një ose më shumë nga këto simptoma/ shenja, duhet të kontaktoni menjëherë me profesionistin që u kujdes për abortin tuaj, pasi kjo mund të jetë shenjë komplikacioni:**

- ethe dhe temperaturë mbi 38°C;
- humbje shumë të madhe të gjakut;
- dhimbje shumë të forta barku;
- gjendje të fikëti (parehati).



---

Udhëzuesi praktik *Ndërprerja e vullnetshme medikale e shtatzënisë në kushte shtëpie*, që gjendet në shtojcën 4 të këtij skedari, ju shoqëron gjatë gjithë kësaj procedure dhe jep të dhëna për simptomat për të cilat kërkohet përkujdesje.

---

### Efektiviteti i metodës

Përqindja e suksesit të metodës medikale është rreth 95%.



---

Në të dyja rastet (IVG-ja medikale ose kirurgjikale), nëse grupi juaj i gjakut është rezus negativ, ju do të merrni një injeksion të gama globulinës anti-D brenda 72 orëve pas fillimit të gjakderdhjes në mënyrë që të shmangen komplikacionet gjatë një shtatzënie të ardhshme. Mos harroni të merrni me vete kartën tuaj të grupit të gjakut.

---

## FAZA E KATËRT: VIZITA PËR NDJEKJEN E GRUAS



### FAZA E KATËRT: VIZITA PËR NDJEKJEN E GRUAS



#### > E DETYRUESHME

Me qëllim që të sigurohem se procesi ka qenë i suksesshëm dhe pa komplikacione



#### KONSULTIMI PSIKOSOCIAL

Nëse ia kam nevojën

Pas IVG-së është absolutisht e domosdoshme të bëni vizitën për ndjekjen e gruas. Kjo vizitë shërben për të siguruar që shtatzënia është ndërprerë si duhet dhe që nuk ka komplikacione.

Ajo duhet të kryhet ndërmjet ditës së 14-të dhe të 21-të pas IVG-së, ndonjëherë më herët në varësi të gjendjes klinike.

- Në rastin e IVG-së kirurgjikale, kryejeni këtë vizitë me mjekun ose maminë.
- Në rastin e IVG-së medikale, ajo kryhet:
  - në kabinetin e mjekut ose të mami-së
  - në një qendër të licencuar të shëndetit seksual (ish-qendër për planifikimin familjar ose edukimin)
  - në një qendër shëndetësore të licencuar
  - në një institucion shëndetësor

Ajo mund të kryhet në distancë si pjesë e një telekonsulte (shih shtojcën 3).

Gjatë vizitës për ndjekjen e gruas, mjeku ose mamia diskutojnë përsëri me ju në lidhje me kontracëionin nëse dëshironi që ai të përshtatet me situatën tuaj.

Ai/ajo ju ofron edhe një intervistë psikosociale nëse dëshironi.





## KONTRACEPSIONI PAS IVG-së



Mundësia e një shtatzënie të re ekziston menjëherë pas një IVG-je. Prandaj është e nevojshme të përdorni një metodë kontraceptive menjëherë pas procedurës së IVG-së, nëse keni nevojë për të.

Vizitat mjekësore të kryera për realizimin e IVG-së ju lejojnë të merrni informacion të detajuar mbi metodat kontraceptive të disponueshme dhe të diskutoni me mjekun ose maminë për të zgjedhur metodën kontraceptive që ju përshtatet. Duke qenë se shtatzënia mund të ndodhë shpejt, metoda kontraceptive e zgjedhur duhet zbatohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas kryerjes së IVG-së.

### Rekomandimi për kontracepsion

Mund të rekomandojnë kontracepsion pas IVG-së:

- mjekët;
- maminë.

Qendrat e shëndetit seksual (ish-CPEF) ofrojnë medikamente ose kontraceptivë falas për të miturit që dëshirojnë të ruajnë sekretin dhe për personat që nuk përfitojnë sigurime shoqërore.

Vizita e parë për kontracepsionin dhe parandalimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (i njohur si CCP) është e hapur për të rejtat nën moshën 26 vjeçare dhe mbulohet në masën 100%<sup>1</sup>. Nuk është i mundur asnjë tejkallim tarife.

Për të rejtat nën 26 vjeçe, i gjithë procesi kontraceptiv i realizuar me një mjek ose mami (vizitat<sup>2</sup>, ekzaminimet biologjike), si dhe dhënia e mjeteve kontraceptive të mbuluara nga sigurimet shëndetësore janë falas dhe mbahen sekret, nëse vajza ose gruaja e re e dëshiron këtë.

1 Për CPP-në nuk lejohet tejkallimi i tarifës.

2 Një vizitë në vit dhe një vizitë për ndjekjen e gruas në vitin e parë të përdorimit të kontracepsionit. Tejkallimet e tarifave nuk mbulohen.

## Zgjedhja e kontracepsionit

Për t'ju ndihmuar në zgjedhjen tuaj, metodat e ndryshme kontraceptive të disponueshme janë renditur në shtojcën 4.

Nuk kundërintikohet asnjë metodë pas IVG-së, përveç ndonjë rasti të veçantë.

## Aplikimi i kontracepsionit

Kontracepsioni i zgjedhur nga gruaja mund të aplikohet sapo të realizohet IVG-ja.

Një aparat intrauterin (prej bakri ose me progesteron) mund të vendoset menjëherë pas kryerjes së IVG-së kirurgjikale (përveç nëse ka infektim) ose gjatë vizitës për ndjekjen e gruas pas IVG-së medikale.

Mund të fillohet kontracepsioni hormonal, estrogjen-progestogjen (pilulë, pullë ngjitëse transdermale) ose progesterogjen (pilula, implant, injeksion intramuskular):

- në të njëjtën ditë ose një ditë pas IVG-së kirurgjikale;
- në ditën e marrjes së misoprostolit - marrja e medikamentit të dytë - në rastin e IVG-së medikale.

Prezervativët e jashtëm (për meshkuj) ose të brendshëm (për femra) mund të përdoren sapo të rifillojnë marrëdhëniet seksuale. Ata janë të vetmit kontraceptivë që mbrojnë kundër infeksioneve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV-AIDS-in.

Për më tepër, mjetet kontraceptive që kërkojnë manipulime vaginale (unaza vaginale, kupola e qafës së mitrës etj.) nuk rekomandohen menjëherë pas ndërhyrjes, gjatë ciklit të parë pas IVG-së.

## Kontracepsioni emergjent

Kontracepsioni emergjent zvogëlon rrezikun e shtatzënisë së padëshiruar pas marrëdhënieve seksuale të pambrojtura ose të mbrojtura dobët (mungesa e kontracepsionit, harrimi i pilulës, çarja e prezervativit etj.).

Nëse është e mundur, të përdoret me raste, sepse nuk mund të zëvendësojë kontracepsionin e rregullt.

Efektiviteti i kontracepsionit emergjent është maksimal nëse merret brenda disa orësh pas marrëdhënies seksuale dhe jo më vonë se 5 ditë pas saj.


Ka dy lloje të kontracepsionit emergjent:

- Kontracepsioni emergjent hormonal, që mund ta merrni pa recetë dhe **100% i rimbursueshëm në farmaci për të gjithë të siguarit që paguajnë sigurime shoqërore**. Është falas dhe lëshohet në mënyrë anonime për të miturat.
- Aparati intrauterin prej bakri është falas kur jepet me recetë (të mjekut, mamiisë) deri në moshën 26 vjeç, më pas rimbursohet me recetë në masën 65% nga moshja 26 vjeç e lart;

Kontracepsioni hormonal emergjent nuk është 100% i besueshëm. Aparati intrauterin është kontracepsioni emergjent më efektiv. Nëse, pavarësisht përdorimit të tij, vëreni një vonesë në menstruacione dhe mbeteni shtatzënë, është e rëndësishme të konsultoheni me mjekun ose maminë.

## Ku mund të gjej informacione shtesë për kontracepsionin?

- Në qendrat e shëndetit seksual (ish-CPEF) ose në institucionet e informimit, konsultimit dhe këshillimit familjar të quajtura rishtazi «EVARS». Adresat dhe të dhënat e kontaktit të këtyre strukturave, të krijuara nga departamenti, mund t'i gjeni në faqet e internetit të përmendura më poshtë.
- Në numrin kombëtar anonim dhe falas « Sexualités – Contraception – IVG »: **0 800 08 11 11**.
- Në faqet e mëposhtme të internetit:
  - <https://questionsexualite.fr/choisir-sa-contraception>: kjo faqe ju ndihmon të zgjidhni metodën kontraceptive që u përshtatet më së miri stilit të jetesës dhe situatës suaj personale;
  - <https://ivg.gouv.fr/>: kjo faqe ju ofron informacione të dobishme për IVG-në dhe kontracepsionin pas IVG-së.



---

# SHTOJCAT

---

## Shtojca 1

**Specifikat e IVG-së te gratë e reja të mitura ..... 22**

## Shtojca 2

**Paketat e IVG-së ..... 24**

## Shtojca 3

**IVG-ja me telekonsultë ..... 27**

## Shtojca 4

**Udhëzues praktik për ndërprerjen e vullnetshme medikale të shtatzënisë në kushte shtëpie ..... 28**

## Shtojca 5

**Mjetet kontraceptive ..... 36**

## Shtojca 6

**Referencat legislative dhe rregullatore ..... 39**

## Specifikat e IVG-së te gratë e reja të mitura

**Ligji lejon çdo grua shtatzënë, përfshirë edhe të miturat, që nuk dëshiron të vazhdojë shtatzëninë, të kërkojë nga mjeku ose mamia që ta ndërpresë atë.**

Nëse jeni e mitur, këtë ndërhyrje duhet ta kërkonti vetë, pa praninë e asnjë personi tjetër.

### Me pëlqimin e prindërve

Ju mund të zgjidhni të kërkonti pëlqimin e njërit prej prindërve ose përfaqësuesit tuaj ligjor dhe kështu të shoqëroheni nga një prej këtyre të afërmeve në procesin tuaj të IVG-së.

### Pa pëlqimin e prindërve

Nëse dëshironi të ruani sekretin ndaj prindërve tuaj ose nëse nuk merret pëlqimi i tyre (prindërit nuk pranojnë të japin pëlqimin ose e keni të pamundur të kontaktoni me njërin prej tyre), IVG-ja dhe procedurat mjekësore – në veçanti anestezia dhe kujdesi përkatës – kryhen me kërkesën tuaj të vetme dhe për këtë arsye nuk kërkohet nënshkrimi i prindërve tuaj për autorizimin për ndërhyrjen kirurgjikale.

Në këto situata, ju duhet të shoqëroheni në procesin tuaj nga një i rritur sipas zgjedhjes suaj, të cilit (cilës) nuk i nevojitet të nënshkruajë asnjë dokument.

**Nëse jeni e mitur dhe e bëni kërkesën, do të ruhet anonimiteti i plotë i kryerjes së abortit, pavarësisht se ku keni zgjedhur të kryeni IVG-në (abordin).**

## Për të mundësuar realizimin e IVG-së:

Ju duhet të keni dokumente që vërtetojnë përfundimin e procedurave të detyrueshme:

- vërtetimin, e dhënë nga mjeku ose mamia, ku konfirmohet se keni respektuar **hapat paraprakë mjekësorë** të detyrueshëm (faza e informimit dhe faza e dhënies së pëlqimit);
- vërtetimin e **konsultimit psikosocial**;
- **konfirmimin tuaj me shkrim** të kërkesës **për IVG-në**;
- **pëlqimin me shkrim të babait ose nënës suaj** (ose të përfaqësuesit tuaj ligjor), ose nëse nuk e keni këtë pëlqim **një dokument që vërteton se keni zgjedhur të rriturin shoqërues**.

## Mbështetja financiare për IVG-në për të miturat

Dispozitat ligjore parashikojnë, për gratë e mitura të paemancipuara dhe pa pëlqimin e prindërve, përveç IVG-së falas, edhe përkujdesje tërësisht anonime.

Pavarësisht nëse IVG-ja është medikale apo kirurgjikale, nuk do të bëhet asnjë kërkesë për pagesë për:

- vizitat para IVG-së;
- ekzaminimet shtesë që mundësojnë veçanërisht përcaktimin e datës së shtatzënisë (analiza gjaku, ekografi etj.);
- vizitën e para-anestezisë nëse është e nevojshme;
- kostot e trajtimit dhe shtrimit në spital për IVG-të e realizuara në një institucion shëndetësor ose kostot që lidhen me realizimin e IVG-së medikale të kryer nga një mjek ose një mami jashtë institucionit shëndetësor (vizitat për dhënien e medikamenteve, vizitat për ndjekjen e gruas pas IVG-së, medikamentet).

## Paketa e IVG-së

Shpenzimet që lidhen me vetë IVG-në, mbulohen në masën 100% nga sigurimet shëndetësore. Që nga 1 prilli i 2016-ës, rimbursohen plotësisht edhe të gjitha ekzaminimet që kanë të bëjnë me IVG-në.

IVG-ja mbulohet në masën 100% në kuadër të një tarife fikse me përjashtim total nga tarifat paraprake për të gjitha gratë që nga viti 2021.

### Kostoja e ekzaminimeve të realizuara në kabinetet private

Nga data 1 prill e 2016-ës, shpenzimet që lidhen me ekzaminimet e nevojshme për kryerjen e IVG-së mbulohen plotësisht në rastin e kabineteve private.

Ato mbulohen në bazë të një recete të lëshuar nga mjeku ose mamia, e shoqëruar me kodet e mëposhtme:

Kodi i shërbimit	Ekzaminimet në fjalë	Tarifat që nga 18 dhjetori i 2019-ës
FPB	Analizat biologjike para IVG-së	69,12 €
FUB	Ekzaminimet biologjike pas IVG-së	17,28 €
IPE	Ekzaminimi ekografik para IVG-së	35,65 €

Gjatë vizitës për ndjekjen e gruas pas IVG-së, mjeku ose mamia mund të lëshojnë faturë edhe për një ekografi kontrolli (vizita dhe ekografia = 30,24 €).

Laboratorët e biologjisë mjekësore dhe qendrat e imazherisë nuk mund të tejkalojnë tarifat për këto procedura.



## Kostoja e IVG-së medikale në kabinetet private

IVG-ja medikale në kabinete private (kabinet mjekësor (mjek ose mami), qendra shëndetësore, qendra të shëndetit seksual (ish-CPEF)) rimburohet në masën 100% nga sigurimet shëndetësore, me çmime të përcaktuara me dekret në çdo fazë.

Mjeku ose mamia që realizon të gjithë IVG-në faturon secilën nga këto faza, kundrejt një shpërblimi në përputhje me paketën e parashikuar me dekret<sup>1</sup>.

Kjo paketë përfshin:

- vizitën mjekësore për dhënien e pëlqimit, përpara IVG-së. Kjo vizitë rimburohet në masën 100% në institucionet mjekësore private, edhe nëse IVG-ja kryhet më pas në spital;
- dy vizitat mjekësore për marrjen e medikamenteve,
- dhënien e medikamenteve;
- vizitën mjekësore për ndjekjen e gruas pas IVG-së (gjatë së cilës mjeku ose mamia mund të vendosë të bëjë një ekografi);
- injektimin e mundshëm të antitropave anti-D për gratë me grup gjaku rezus negativ.

Kur procedura e IVG-së realizohet me telekonsultë, mjeku dhe mamia marrin shpërblimin për vizitat e kryera, ndërsa farmacisti merr një tarifë fikse për dhënien e medikamenteve.

## Kostoja e IVG-së medikale në institucionin shëndetësor

IVG-ja medikale në institucionin shëndetësor (spital, klinikë) rimburohet në masën 100% nga sigurimet shëndetësore në bazë të një tarife fikse të vendosur midis 353.64 € dhe 376.77 € në varësi të monitorimit mjekësor dhe të ekografisë pas ndërhyrjes.

Ky çmim përfshin:

- analizat laboratorike para IVG-së;
- ekografinë para IVG-së;
- vizitën mjekësore për dhënien e pëlqimit, para abortit, nëse ky i fundit nuk është kryer në kabinet ose në institucion mjekësor privat;

<sup>1</sup> Dekretet e 26 shkurtit të 2016-ës për paketat e përgjithshme për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë, dhe që nga 1 qershori i 2021-shit.

- dy vizitat (konsultat) mjekësore për marrjen e medikamenteve, medikamentet dhe vizitën mjekësore për ndjekjen e gruas pas IVG-së (gjatë së cilës mjeku ose mamia mund të vendosë të bëjë një ekografi);
- injeksionin e mundshëm me antitruapat anti-D për gratë me grup gjaku rezus negativ;
- analizën e ekzaminimit biologjik pas IVG-së.

Ekzaminimet biologjike dhe ekografitë e kryera para dhe pas IVG-së rimburohen në masën 100%.

### Kostoja e IVG-së kirurgjikale

IVG-ja kirurgjikale rimburohet në masën 100% nga sigurimet shëndetësore në bazë të një tarife fikse që varion nga 504.41 € në 830.06 € në varësi të strukturës (institucioni shëndetësor - spital ose klinikë - ose qendër shëndetësore), lloji i anestezisë (lokale ose e përgjithshme) dhe kohëzgjatja e shtrimit në spital.

Ky çmim përfshin:

- vizitën mjekësore për dhënien e pëlqimit, para abortit, nëse ky i fundit nuk është kryer në kabinet ose në institucion mjekësor privat;
- analizat para IVG-së;
- anestezinë lokale ose të përgjithshme dhe vizitën para-anestezike nëse është e nevojshme, procesin e IVG-së dhe monitorimin, pritjen dhe akomodimin;
- vizitën mjekësore për ndjekjen e gruas pas IVG-së (gjatë së cilës mjeku ose mamia mund të vendosë të bëjë një ekografi).

Paketa ditore nuk është e faturueshme.




---

Gratë që nuk përfitojnë të drejtën e sigurimit shëndetësor mund të përfitojnë trajtim falas vetëm në një institucion spitalor.

---

## IVG-ja me telekonsultë

IVGi-ja mund të realizohet pjesërisht ose tërësisht në distancë, me telemjekësi, me kryerjen e vizitave nga larg, midis gruas dhe profesionistit mjekësor. Vetëm IVG-ja kirurgjikale nuk mund të realizohet nga larg.

Kështu, mund të kryhen nga distanca, në telekonsultë:

- faza e informimit,
- nëse është e nevojshme, intervista psikosociale,
- faza e nevojshme për të marrë pëlqimin dhe lëshimin e recetave:
  - Prandaj, gjatë telekonsultës, gruaja i tregon profesionistit të kujdesit shëndetësor se cila farmaci do t'ia dorëzojë asaj medikamentet;
  - Kështu, dorëzimi i medikamenteve abortive të gratë kryhet nga farmacistët pas telekonsultës, dhe pas marrjes së recetës së dërguar nga profesionisti shëndetësor, pa e faturuar gruan.
- marrja e medikamenteve në kushte shtëpie,
- ndjekja e gruas pas IVG-së.

Këto faza mund të kryhen me vizitë mjekësore nga largësia (me telekonsultë) ose duke qenë fizikisht të pranishme, në varësi të zgjedhjes së profesionistit shëndetësor dhe të gruas. Profesionisti shëndetësor është i lirë të ofrojë vizitë mjekësore në distancë ose jo: ai mund të vendosë që, në varësi të gjendjes shëndetësore të gruas, të kryejë një vizitë me prani fizike. Gruaja është e lirë të pranojë ose të refuzojë telekonsultën. Përveç kësaj, ajo mund ta tërheqë në çdo kohë pëlqimin e saj dhe të kërkojë përkujdesjen shëndetësore me prani fizike nëse ajo dëshiron.

Konfidencialiteti i të dhënave dhe sekreti mjekësor garantohen nga përdorimi i mjeteve të dedikuara për praktikën e telemjekësisë.

Kostoja dhe mbulimi janë të njëjtë qoftë në rastin e IVG-së që bëhet në praninë fizike të profesionistit, qoftë në distancë nëpërmjet telemjekësisë.

## Udhëzues praktik për ndërprerjen e vullnetshme medikale të shtatzënisë në kushte shtëpie



MËSO MË SHUMË

[WWW.IVG.GOUV.FR](http://WWW.IVG.GOUV.FR)



MINISTÈRE  
DE LA SANTÉ  
ET DE LA PRÉVENTION

*Liberté  
Égalité  
Fraternité*

## Ndërprerja e vullnetshme medikale e shtatzënisë në kushte shtëpie

Udhëzues praktik



# Përmbledhje

- 1- SI FUNKSIONON IVG-ja MEDIKALE ..... fq. 4
- 2- KUR MUND TË SHQETËSOHENI DHE ÇFARË TË BËNI? .. fq. 6
- 3- PO MË PAS, SI DO TË NDIQET GRUAJA? ..... fq. 7

*Ky udhëzues praktik duhet t'i jepet gruas kur profesionisti i kujdesit shëndetësor lëshon ose jep recetën e mjekimit. Ai nuk mund ta lirojë profesionistin nga detyrimi ligjor për t'i dhënë gruas dosjen e plotë të saj gjatë vizitës së informimit.*

## 1 - SI FUNKSIONON IVG-JA MEDIKALE?

Dy medikamente të ndryshme duhet të merren 24/48 orë larg njëritjetrit: **mifepriston**, pastaj **misoprostol**. Këto medikamente ju lëshohen ose ju jepen me recetë nga mjeku ose mamia.

### → ditën kur merrni medikamentin e parë (mifepristone) dhe të nesërmen

Zakonisht nuk ka **reaksione serioze** pas marrjes së këtij medikamenti. Mund të keni pak gjakderdhje. Shumë rrallë, mund të keni gjakderdhje më të madhe me dhimbje. Mos hezitoni të merrni **mjekimet kundër dhimbjeve** që mjeku ose mamia ju ka rekomanduar. Nëse këto nuk ndalen, flisni me mjekun ose maminë tuaj.

Ju mund t'i kryeni aktivitetet tuaja normalisht.

### → ditën kur merrni medikamentin e dytë (misoprostol)

Edhe nëse tashmë keni gjakderdhje pas marrjes së mjekimit të parë, është **e domosdoshme** që të merrni të dytin sipas planit. Në të vërtetë, medikamenti i parë ka filluar ndërprerjen e shtatzënisë. Është kombinimi i këtyre 2 medikamenteve që shkakton kontraktime dhe çon në IVG. Prandaj është e nevojshme që të merret.


Rekomandohet t'i merrni medikamentet kundër dhimbjeve 15 deri në 30 minuta përpara se të merrni misoprostol për t'u paraprirë dhimbjeve që do t'ju shkaktojë ky medikament.

Gjakderdhja mund të jetë më e madhe se ajo e menstruacioneve. Mund të shoqërohet me dhimbje, si dhimbjet menstruale ose më të forta.

**Efektet anësore** janë të mundshme: të përziera ose të vjella, ndonjëherë diarre, rritje e temperaturës në 38°C. Këto simptoma zgjasin vetëm për disa orë.

Aborti më së shpeshti ndodh brenda **4 orëve** nga marrja e medikamentit të dytë. Ndonjëherë do të ndodhë më herët ose më vonë (deri në 3 ditë).





### Që të gjitha shanset të jenë në favorin tuaj:

- Mos planifikoni udhëtime ose ngjarje të rëndësishme për 3 ditë, sepse shpesh aborti ndodh shpejt, por ka raste kur ndodh brenda 3 ditëve.
- Krijoni kushte të rehatshme në shtëpi ose me dikë tek i cili/e cila keni besim.
- Mos qëndroni vetëm, sepse mund të keni nevojë për ndihmë (nëse paraqitet nevoja).
- Nëse keni fëmijë, sigurohuni që dikush të kujdeset për ta për disa orë pas marrjes së medikamentit të dytë.
- Merrini medikamentet kundër dhimbjeve, që ju ka rekomanduar mjeku ose mamia, para se të keni dhimbje, sipas udhëzimeve në recetën e mjekut.



## 2 - KUR MUND TË SHQETËSOHENI DHE ÇFARË TË BËNI?

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse keni të vjella më herët se 30 minuta pas marrjes së medikamenteve</li> </ul>	<p><i>Kontaktoni përsëri me qendrën mjekësore, mjekun ose maminë që është kujdesur për realizimin e IVG-së (abortit).</i></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse keni shumë gjakderdhje, d.m.th nëse ju duhet të ndërroni pecetat higjienike çdo 30 minuta (peceta me përmasë maksimale) për më shumë se dy orë rresht.</li> </ul>	<p><i>Shkoni në shërbimin e urgjencës së rekomanduar nga mjeku ose mamia. Merrni me vete formularin tuaj të ndërlidhjes dhe, nëse është e mundur, kartën tuaj shëndetësore.</i></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse keni dhimbje shumë të forta pavarësisht medikamenteve kundër dhimbjeve që ju janë dhënë me recetë</li> </ul>	<p><i>Flisni me mjekun ose maminë që është kujdesur për realizimin e IVG-së ose shkoni direkt në urgjencë.</i></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse keni temperaturë (ethe) gjatë ditëve pas marrjes së dozës së dytë të medikamentit</li> </ul>	<p><i>Flisni me mjekun ose maminë që është kujdesur për realizimin e IVG-së.</i></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse nuk keni gjakderdhje ose vetëm pak brenda 3 ditëve pas dozës së dytë të medikamentit</li> </ul>	<p><i>Flisni me mjekun ose maminë që është kujdesur për realizimin e IVG-së (pa pritur vizitën e planifikuar për ndjekjen e gruas).</i></p>

Në rast shqetësimi, kontaktoni fillimisht me mjekun ose maminë që është kujdesur për realizimin e IVG-së në numrin: .....

### Në rast urgjence, kontaktoni:

→ institucionin e kujdesit shëndetësor të rekomanduar nga mjeku ose mamia juaj

• numri .....

• adresa .....

→ 112 ose 15

### 3 - PO MË PAS, SI DO TË NDIQET GRUAJA?


#### Vizita për ndjekjen e gruas

Është normale të ketë gjakderdhje për dy javë, ndonjëherë deri në vizitën për ndjekjen e gruas.

**Kjo vizitë është e domosdoshme**, sepse bën të mundur verifikimin që shtatzënia është ndërprerë vërtet dhe që nuk ka nevojë për ndonjë procedurë shtesë. Në të vërtetë, në një numër shumë të vogël rastesh, shtatzënia mund të vazhdojë të përparojë pavarësisht gjakderdhjes së rëndë.

#### Takimi caktohet 14 deri në 21 ditë pas IVG-së

Kam një takim në: \_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_

#### Muajin tjetër

Nëse nuk keni menstruacione ose gjakderdhje 4 deri në 6 javë pas IVG-së (abortit), kontaktoni me qendrën, mjekun ose maminë që është kujdesur për IVG-në tuaj.



#### BËNI KUJDES

Mund të mbeteni shtatzënë edhe në muajin e parë pas abortit. Kjo është arsyeja pse është jashtëzakonisht e rëndësishme që, sa më herët që është e mundur, të flisni për kontracepsionin me mjekun ose maminë tuaj, i cili/e cila do t'ju rekomandojë metodën që i përshtatet më së miri mënyrës suaj të jetesës.

Të gjitha informacionet mbi këtë temë mund t'i gjeni në faqen e internetit: <https://questionsexualite.fr/choisir-sa-contraception>

**MËSO MË SHUMË:**

**WWW.IVG.GOUV.FR**





**0 800 08 11 11**

**Shërbimi dhe telefonata  
anonime dhe falas**

Sexualités - Contraception - IVG (abort)

Numri i aksesueshëm në Francën metropolitane dhe në DOM  
(Departamenti i përtejdetit):  
të hënën nga ora 9:00 deri në orën 22:00 dhe nga e marta në të  
shtunën nga ora 9:00 deri në 20:00.





## METODAT E NDRYSHME KONTRACEPTIVE

METODA	ÇMIMI <sup>1</sup>	SI TA MERRNI? <sup>2</sup>
<p> <b>DIU-ja (aparati in tauterëin)</b></p> <p>Ka dy lloje: bakri ose levonorgestrel. DIU-ja (i quajtur më parë « sterilet ») vendoset në mitër nga një mjek ose mami. Vendosja zgjat disa minuta. Mund të hiqet nga mjeku ose mami kur të dëshirojë gruaje.</p> <p>Është e faktiv për 4 deri në 10 vjet, në varësi të modelit. Ka një kohëzgjatje të gjatë veprimi dhe ju lëjon ta keni mendjen të qetë.</p>	<p><b>DIU-ja prej bakri: 34 €.</b></p> <p>DIU-ja hormonale: nga 96 deri në 107 €.</p> <p>Rimbursohet në masën 65%.</p> <p>Falës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>për gratë nën 26 vjeçe: në farmaci<sup>2</sup> dhe, pavarësisht moshës, në qendrat e shëndetit seksual (Ish-CPEF<sup>3</sup>);</li> <li>për të pasiguruarat: në CPEF<sup>3</sup>.</li> </ul>	<p>Rekomandohet, vendoset dhe hiqet nga mjeku ose mami.</p> <p>Merret me recetë në farmaci.</p>
<p> <b>PILULAT KONTRACEPTIVE</b></p> <p>Tableta që duhet të merren cdo ditë në kohë të rregullt për 21 ditë ose 28 ditë, në varësi të llojit të pillulës.</p> <p>Ka dy lloje: pillula të kombinuara estrogen-progjestogjen që përmbajnë dy hormone dhe pillula vetëm me progjestogjen që përmbajnë vetëm një hormon.</p> <p>Pillulat e kombinuara të estrogenit klasifikohen sipas gjeneratës së progjestogjenit.</p> <p>Lloji i preferuar i gjeneratës që do të merret caktohet me mjekun e kujdesit shëndetësor, i cili/ jua vizituar.</p>	<p>Afësisht 1,50 €/muaj për pillulat e rimbursuara në masën 65% (d.m.th. për pillulat e gjeneratës së parë dhe të dytë). Të tjerët janë me tarifim të lirë.</p> <p>Falës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>për gratë nën 26 vjeçe: në farmaci<sup>2</sup> dhe, pavarësisht moshës, në qendrat e shëndetit seksual (Ish-CPEF<sup>3</sup>);</li> <li>për të pasiguruarat: në qendrat e shëndetit seksual (Ish-CPEF<sup>3</sup>).</li> </ul>	<p>Rekomandohet nga mjeku ose mami. Mund të rinovohet nga një infermiere për jo më shumë se 6 muaj.</p> <p>Merret me recetë në farmaci.</p> <p>Farmacisti mund të rinovojë lëshimin e saj për jo më shumë se 6 muaj.</p>
<p> <b>PULLA NGJITËSE KONTRACEPTIVE</b></p> <p>Pullë (coopë) që mund ta ngjisni vetë në lëkurë një herë në javë dhe që ndërrohet cdo javë, për 3 javë.</p> <p>Gjatë javës së 4-të, edhe pse nuk vendosni pullë, jeni të mbrojtura. Mospendosija e pullës shkakton fillimin e menstruacioneve.</p> <p>Pulla është metodë estrogen-progjestogjeni, sepse përmban dy lloje hormone: një estrogen-progjestogjen dhe një progjestogjen. Për mundësinë e përdorimit duhet të flisni me një profesionist të kujdesit shëndetësor.</p>	<p><b>Rreth 15 €/muaj.</b></p> <p>Sipas çmimit të tregut. Nuk rimbursohet.</p>	<p>Rekomandohet nga mjeku ose mami. Merret me recetë në farmaci.</p>
<p> <b>IMPLANTI KONTRACEPTIV</b></p> <p>Një shufër cilindrike 4 cm e gjatë dhe 2 mm e gjerë që futet nën lëkurën e krushut, me anestezil lokale. Vendosja zgjat disa minuta. Mund të hiqet nga një mjek ose një mami kur të dëshirojë gruaje. Implanti mund të lhet aty për 3 vjet. Implanti është metodë kontraceptive hormonale.</p>	<p><b>103 €.</b></p> <p>Rimbursohet në masën 65%.</p> <p>Falës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>për gratë nën 26 vjeçe: në farmaci<sup>2</sup> dhe, pavarësisht moshës, në qendrat e shëndetit seksual (Ish-CPEF<sup>3</sup>);</li> <li>për të pasiguruarat: në qendrat e shëndetit seksual (Ish-CPEF<sup>3</sup>).</li> </ul>	<p>Rekomandohet, vendoset dhe hiqet nga mjeku ose mami.</p> <p>Merret me recetë në farmaci.</p>

(1) Çmime publike ilustruese që vlenin në Francën metropolitane në 2016-ën.

(2) Për të miturcat të pakten 15 vjeçe të siguruara ose që e gjejnë të drejtën për sigurime shoqërore.

(3) Qendrat për Planifikimin dhe Edukimin Familjar.




METODA	ÇMIMI!	SI TA MERRINI?
<p> <b>UNAZA VAGJINALE</b></p> <p>Unazë fleksibile që mund ta vini vetë në vagjinë, thjeshtë, siç vini tamponin. Lihet aty për 3 javë. Në fillim të javës së 4-të e heqin vetë unazën, gjë që shkakton nisjen e menstruacioneve.</p> <p>Jeni të mbrojtura edhe gjatë periudhës së mosvendosjes së saj. Kjo ju lejon të përfitorni nga kontracepsioni efektiv pa menduar për të për 3 javë.</p> <p>Unaza vagjinale është metodë estrogen-progestogjeni, sepse përmban dy lloje hormoneesh: një estrogen-progestogjen dhe një progestogjen. Për mundësinë e përdorimit duhet të flisni me një profesionist të kujdesit shëndetësor.</p>	<p><b>ÇMIMI!</b></p> <p><b>Reeth 16€ /muaj.</b></p> <p>Sipas çmimit të tregut. NUK rimbursohet.</p>	<p><b>SI TA MERRINI?</b></p> <p>Rekomandohet nga mjeku ose mamia. Merrt me receta në farmaci.</p>
<p> <b>DIAFRAGMA DHE KUPOLA E QAFËS SË MITRËS</b></p> <p>Diaphragma është kupolë silikoni që e vendosni vetë në vagjinë. Përdoret e kombinuar me një produkt spermicid. Diaphragma pengon kalimin e spermës.</p> <p>Kupola është një send shumë i hollë silikoni që mbulon qafën e mitrës.</p> <p>Diaphragma ose kupola e qafës së mitrës mund të vendoset në momentin e aktit seksual, por edhe disa orë përpara. Është e rëndësishme ta mbani për 8 orë pas marrëdhënies seksuale. Mund të ripërdoret.</p>	<p><b>Nga 20 € deri në 60 €.</b></p> <p>Diaphragma rimbursohet në masën 3,14 €.</p> <p>Kupola e qafës së mitrës, me çmim tregu, nuk rimbursohet.</p>	<p>Rekomandohet nga mjeku ose mamia që ju mëson si ta vendosni. Merrt me receta në farmaci. Diaphragmën mund ta merrni në qendrat e shëndetit seksual (CSS). Spermicidet që shoqërojnë përdorimin e diaphragmës mund të blihen në farmaci pa receta.</p>
<p> <b>PREZERVATIVI I JASHTËM (PËR MESHKJË)</b></p> <p>Prej latexi ose poliuretani. Shpërvishet mbi penisin e erektuar përpara penetrimit dhe mban spermën. Para përfundimit të erekSIONIT, të tërhiqet duke e mbatur prezervativin në bazën e penisit, më pas të lidhet njëjtë dhe të hidhet në kosh. Prezervativi duhet të ndërrohet pajtëherë në çdo marrëdhënie seksuale. Prezervativi mund të përdoret edhe me një xhel lubrifikues. Bashkë me prezervativin për femra, është e vëmendjeje metodë kontraceptive që ju mbrojnë nga HIV-i dhe nga shumica e infeksioneve të tjera seksuale të transmetueshme (ST).</p>	<p><b>Nga 56 centë</b> prezervativit. Disa marka të prezervativëve të disponueshëm në farmaci mbulojnë në masën 100% nga Sigurimet Shëndetësore pa receta mjekësore deri në moshën 26 vjeç.</p> <p>Mbi moshën 26 vjeç, ato lëshohen me receta mjekësore dhe 60% mbulojnë nga sigurimet shëndetësore.</p>	<p>Merrt pa receta në farmaci, supermarkete, makinë të shitjes dhe në internet.</p>
<p> <b>PREZERVATIVI I BRENDSHËM (FEMËROR)</b></p> <p>Moulesë nitritil ose poliuretani e pajisur me një unazë fleksibile në të dyja skajet, e cila vendoset në vagjinë. Mund të vendoset disa orë para marrëdhënies seksuale. Prezervativi duhet të ndërrohet pajtëherë në çdo marrëdhënie seksuale.</p> <p>Bashkë me prezervativin për meshkuj, është e vëmendjeje metodë kontraceptive që ju mbrojnë nga HIV-i dhe nga shumica e infeksioneve të tjera seksuale të transmetueshme (ST).</p>	<p>Falës në CSS? (ish-CPEF) dhe CeGIDD?<sup>3</sup></p> <p><b>Reeth 8,30 € kutia me 3 prezervativë.</b> Sipas çmimit të tregut. NUK rimbursohet.</p> <p>Falës në CSS? (ish-CPEF)<sup>3</sup> dhe CeGIDD<sup>4</sup></p>	<p>Merrt pa receta në farmaci dhe në internet.</p>

1 Çmime publike ilustruese që vlenin në Francën metropolitane në 2019-ën.

2 Qendra e Shëndetit Seksual (CSS)

3 Qendrat për Planifikimin dhe Edukimin Familjar.

4 Qendrat e informimit, depozitimi dhe diagnostikimi falas për HIV, hepatitin viral dhe sëmundjet e tjera seksuale të transmetueshme.

METODA	ÇMIMI	SI TA MERRNI?
 <p><b>SPERMICIDET</b> Spermicidet vijnë në formën e xhelit dhe vezës të cilat vendosen në vaginë disa minuta para çdo marrëdhënieje seksuale dhe shkatërrojnë spermatozoidet. Kontracepsion emergjent.</p>	<p>Rreth <b>5 deri në 20 €</b> në varësi të llojit, për disa doza. Sipas çmimit të tregut. Nuk rimbursohet.</p>	<p>Merrret pa recetë në farmaci.</p>
 <p><b>INJEKSIONET PROGESTATIVE</b> Progesterogjen sintetik (medroksiprogesteron) që injektohet me injeksion intramuskular çdo tre muaj. Për 12 javë, produkti siguron kontracëpsion të vazhdueshëm. Injeksionet duhet të bëhen në intervale të rregullta nga një mjek, infermiere ose mami. Injeksionet proggestative janë metode kontracëpsive hormonale.</p>	<p>Çdo dozë kushton <b>3 €</b>. Falas:  <ul style="list-style-type: none"> <li>Në qendrat e shëndetit seksual për të miturat dhe të pasiguruarat</li> <li>Në farmaci për personat nën 26 vjeç sipas kushteve</li> </ul> </p>	<p>Merrret me recetë në farmaci.</p>
 <p><b>METODAT E STERILIZIMIT PËR QËLLIME KONTRACËPSIVE</b> Këto metoda mund të paraqesin rrezik për përdorim të rëndësishëm burra ose gra. Ato shkaktojnë sterilitet i cili konsiderohet i përhershëm. Nderhyrja duhet të jetë rezultat i një vendimi personal dhe kryhet në një institucion shëndetësor. Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit: <a href="https://questionssexeualite.fr/ose/www.sante.gouv.fr/rubrika%20contraception%20shih%20brshuren%20e%20informacioneve">https://questionssexeualite.fr/ose/www.sante.gouv.fr/rubrika "kontracepsion"</a> (shih brshurën e informacioneve: Sterilisation à visée contraceptive (Sterilizimi për qëllime kontracëpsive)).</p>	<p>Rimbursohet në masën 80%.</p>	<p>Nderhyrja nuk mund të kryhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>përveçse pas një vizite fillestare informimi për aspektet shëndetësore,</li> <li>pas personi të jetë menduar për një periudhë 4 mujore pas kësaj vizite të parë,</li> <li>dhe pas kontrollimit me shkrim nga personi i interesuar i cili shfaq dëshirën e tij/saj për të kryer ndërhyrjen.</li> </ul>

(1) Çmime publike ilustruese që vlenin në Francën metropolitane në 2016-ën.



Disa metoda mund të kenë efekte anësore negative për të cilat do t'ju informojë profesionisti i kujdesit shëndetësor me të cilin do të flisni. Ekzistojnë gjithashtu disa metoda "natyrale" të kontracëpsionit si tërheqja ose abstenenca periodike (metodat Ogino, Billings dhe metoda e temperaturave). Megjithatë, këto metoda nuk janë shumë të besueshme.

Cilido qoftë metoda që zgjidhni, mbani mend që prezervativi (për meshkuj ose për femra) është i vetmi mjet kontracëpsiv që t'ju mbrohet nga HIV-1 dhe nga shumica e sëmundjeve të tjera që transmetohen në rrugë seksuale. Mund të kombinohet edhe me një metodë tjetër kontracëpsive: kjo quhet "mbrojtje e dyfishtë".

## Referencat legislative dhe rregullatore

### IVG-ja: e drejtë e garantuar me ligj

Ligji (neni L. 2212-1 i Kodit të Shëndetit Publik) lejon çdo grua shtatzënë, të rritur ose të mitur, që nuk dëshiron të vazhdojë shtatzëninë, të kërkojë nga mjeku ndërprerjen e saj. Një kërkesë të tillë mund ta bëjë vetëm gruaja e interesuar.

Kjo e drejtë garantohet me ligj. Pengimi i IVG-së është vepër e dënueshme me dy vjet heqje lirie dhe gjobë prej 30,000 eurosh.

### 2022

---

#### → 2 mars

Ligji nr. 2022-295, që synon forcimin e së drejtës për IVG-në, zgjat afatin ligjor për IVG-në kirurgjikale nga 12 në 14 javë të shtatzënisë dhe afatin ligjor për IVG-në medikale nga 5 javë në 7 javë shtatzënie. Gjithashtu mundëson kryerjen e IVG-së medikale me telekonsultë. Me këtë ligj, autorizohen mamitë e trajnuara që të kryejnë IVG-në kirurgjikale në institucionet

shëndetësore. Ai heq afatin minimal një javor për të menduar si për të miturat ashtu edhe për të rriturat. Së fundi, ligji dënon refuzimin e dhënies emergjente të kontracepsionit.

#### → 23 dhjetor

Ligji nr. 2022-1616 «Për financimin e sigurimeve shoqërore për vitin 2023» lejon akses falas dhe pa recetë në kontracepsionin emergjent për të gjithë të siguarit që paguajnë sigurime shoqërore.

### 2016

---

#### → 26 janar

Ligji nr. 2016-41 «Për modernizimin e sistemit shëndetësor» heq afatin minimal njëjavor për të menduar, për të rriturat. Gjithashtu i lejon mamitë të kryejnë IVG-në medikale dhe qendrat shëndetësore të kryejnë IVG-në kirurgjikale.

## 2014

---

→ 4 gusht

Ligji nr. 2014-873 i 4 gushtit 2014 “Për barazi reale midis grave dhe burrave” heq nocionin e shqetësimit të kushteve për rekurs ndaj IVG-së dhe e shtrin veprën penale të pengimit të IVG-së për aksesin në informim mbi IVG-në.

## 2001

---

→ 4 korrik

Ligji nr. 2001-588 “Për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë dhe kontracepsionin” reformon ligjet “Neuwirth” për kontracepsionin (1967) dhe “Veil” për IVG-në (1975), zgjat afatin ligjor nga 10 në 12 javë të shtatzënisë dhe lehtëson kushtet e përdorimit të kontrceptivëve dhe kryerjen e IVG-së për të miturat.

## 2000

---

→ 13 dhjetor

Shpallet ligji nr. 2000-1209 “Për kontracepsionin emergjent”.

## 1993

---

→ 27 janar

Ligji nr. 93-121 parashikon, në veçanti, si vepër penale pengimin e ndërprerjes së vullnetshme të shtatzënisë dhe nuk e konsideron më si vepër penale abortin vetjak (autoabordin).

## 1982

---

→ 31 dhjetor

Ligji nr. 82-1172 “Për mbulimin e kostove që lidhen me ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë joterapeutike dhe për mënyrat e financimit të kësaj mase” parashikon mbulimin nga shteti të shpenzimeve të sigurimit shëndetësor për IVG-në.

## 1979

---

→ 31 dhjetor

Ligji nr. 79-1204 “Për IVG-në” vë përfundimisht në fuqi dispozitat e ligjit të vitit 1975, me të cilin largohen veçanërisht disa pengesa për kryerjen e IVG-së.



## 1975

---

→ 17 janar

Miratohet për një periudhë pesëvjeçare [ligji nr. 75-17](#), me të cilin autorizohet ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë (IVG). Ligji njihet si «ligji 'Veil'».

## 1974

---

→ 4 dhjetor

Ligj që përmban dispozita të ndryshme në lidhje me kontrollin e lindjeve, i cili liberalizon kontracepsionin dhe zgjeron dispozitat e ligjit të vitit 1967: në veçanti rimbursimi i kontracepsionit nga sigurimet shoqërore dhe heqja e autorizimit prindëror për të miturat ([ligji nr. 74-1026](#)).

→ 13 nëntor - 20 dhjetor

Pas një procesi të gjatë legjislativ, projektligji për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë, i paraqitur në Këshillin e Ministrave më 13 nëntor, u miratua më 20 dhjetor nga Asambleja Kombëtare.

Ligji autorizon IVG-në brenda 10 javësh, me kërkesë të thjeshtë të mjeku; i lë mundësinë çdo mjeku ose çdo institucioni spitalor privat të refuzojë ndjekjen e kërkesës për IVG; përpiqet të kufizojë IVG-të në rastet e domosdoshmërisë dhe të parandalojë që ato të bëhen mjet për rregullimin e lindjeve. Nuk parashikon rimbursim nga sigurimet shoqërore, por mbulimin e ndihmës mjekësore sipas kërkesës.

## 1967

---

→ 28 dhjetor

[Ligji nr. 67-1176](#) «Për rregullimin e lindjeve», i njohur si «ligji 'Neuwirth'», autorizon prodhimin dhe importimin e kontraktivëve, shitjen e tyre ekskluzive në farmaci me recetë mjekësore, me autorizimin e prindit për të miturat, dhe ndalon çdo reklamë komerciale ose propagandë kundër lindjeve.





